



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
 PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. VI
 Br. No. 3159 / 2025 - IN
 Nr. Fa. 4 Data Datum 16.09.2025
 Br. Str. No. Pg. Prishtinë / Pristina

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA - SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

1

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
---	--	---

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-24-0109	05.09.2025
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:
Aktvendim		04.09.2025

			AKP - Prishtinë
		Received by	
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrimi	Retpis:	Signature	





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:201153
Datë: 04.09.2025
Numri i dokumentit: 07699498

C-IV-24-0109

19 korrik 2024

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL), i Ndërmarrjes Shoqërore “Erozioni” në likuidim, në Pejë

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Parashtruesin e kërkesës

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 04 shtator 2025, lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. **Aprovohet** Raporti Përfundimtar i AL-së të Ndërmarrjes Shoqërore PEJ069 NSH “Erozioni” në likuidim, në Pejë
2. **Lejohet** mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrje .
3. **Lirohet** AL nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 12 korrik 2024, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme raportin përfundimtar të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore (tani e tutje NSH) PEJ069 NSH “Erozioni” Pejë në likuidim në Pejë, duke propozuar që pas shqyrtimit të aprovoj Raportin Përfundimtar të bie vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje. Parashtruesi i kërkesës më tej ka pohuar se këtë kërkesë e paraqet në pajtim me nenet 43 dhe 44 të Shtojcës së



Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së).

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashton raportin përfundimtar Dhomës së Posaçme.

Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të bilancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3, i këtij neni përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës të kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimi të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Me 01 nëntor 2022, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerr vendim për themelimin dhe përbërjen e Autoritetit të Likuidimit për NSH "Erozioni" në likuidim në Pejë.

Me 11 nëntor 2010, Autoriteti i Likuidimit pasi kishte iniciuar procesin e likuidimit të kësaj NSH-je, ka publikuar Njoftimin e parë për fillimin e Likuidimit në gjuhën shqipe dhe serbe në gazetën Koha Ditore dhe Kosova Sot si dhe në gjuhën serbe në gazetën Blic, në Serbi. Njoftimi të dytë ishte bërë me dt. 18 nëntor 2010 gazetën e përditëshme Koha Ditore dhe Kosova Sot dhe në gjuhën serbe në gazetën Blic, poashtu Bordi i Drejtorëve kishte vendosur që të gjitha njoftimet për kreditorët e AKP-së të bëhen në web faqen e AKP-së të cilat edhe janë bërë. Raportit i janë bashkëngjitur dëshmitë e publikimit të këtyre njoftimeve.

AL ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj NSH-je tek institucionet relevante dhe kreditorët potencialë. Me dt. 18 nëntor 2010, janë njoftuar Administrata Tatimore e Kosovës, zyra e tatimit në pronë, KEK në Pejë, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, Zyra për Regjistrimin e Pengut e kësaj Agjencie, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe KK Pejë. Me 25 nëntor 2010 për fillimin e likuidimit ndaj kësaj NSH-je ishin njoftuar edhe Gjykata Themelore në Pejë dhe degët e saj Deçan, Istog Klinë, Gjykata Themelore e Gjakovës Gjykata e Qarkut në



Numri i lëndës: 2024:201153
Datë: 04.09.2025
Numri i dokumentit: 07699498

Pejë, Gjykata Ekonomike Prishtinë, Gjykata Supreme e Kosovës si dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës . Poashtu ishin njoftuar degët e bankave në Pejë siq janë ProCredit Bank Raiffaisen Bank, Banka Ekonomike, Banka për Biznes, TEB Bank dhe NLB Prishtina në Pejë.

Raporti i AL-së që ka të bëjë me transaksionet e privatizimit shifet se përbëhet nga marrëveshtja e shitblerjes, deklarata e transferit të pronës së paluajtshme dhe deklarata e transferit të aseteve të caktuara dhe obligimeve të "Erozionit " për te Sali Asllani e ratifikuar me 17 dhjetor 2009 dhe çmimi i blerjes ishte 256,000.00€ ndërsa, procesi i likuidimit përmban marrëveshtjen për shitblerjen e aksioneve, deklarata e transferit të palujtshmërisë dhe deklarata e transferit të aseteve të caktuara dhe obligimeve të NSH"Erozioni " Sh.p.k. blerësit Sokol Elshani me numër të letërnjoftimit 1003285932 dhe adresë Ozdrin Pejë, Kosovë e ratifikuar me dt 07 qershor 2012.

Dhoma e Posaçme ka konfirmuar se nuk ka ndonjë padi ndaj kësaj NSH-je.

AL në Pasqyrën Përfundimtare Financiare ka deklaruar se të ardhurat nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit kanë qenë në shumën prej 294,495.11 €, dhe nga këto mjete janë kryer të gjitha shpenzimet- llojet e ndryshme të shpërndarjes si dhe pagesat e kreditorëve në shumën prej 119,481.07 € dhe tani ndërmarrja në fjalën nuk ka ndonjë pasuri në posedim ose pronësi, ndërsa pas shpenzimeve të likuidimit Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës ishin në vlerën prej 140,134.34 € .

AL mbetet përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46 paragrafi 2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Andaj nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare
Hajrie Shala

